

A i ke paguar ti tarifat e duhura për kujdesin ndaj fëmijëve për vitin 2014?

Që të paguhen tarifat e duhura të kujdesit për fëmijët, kjo është një çështje e saktësisë. Për këtë arsye Komuna e Uddevallës po e bën një kontrollim të tarifave për parashkolloret, për përkujdesjet ditore të fëmijëve, për shtëpitë e kohës së lirë dhe për klubet e kohës së lirë që janë paguar gjatë vitit 2014. Të dhënat që ti si kujdestar i ke dorëzuara në komunë, krahasohen me të ardhurat vjetore të familjes tënde te Administrata e Tatimit (Skatteverket). Kontrollimet e tarifave në vazhdim do të bëhen për çdo vit.

A ke paguar vti më pak apo më shumë?

Ti si kujdestar e ke përgjegjësinë për të njoftuar të ardhura korrekte dhe për raportet familjare ashtu që tarifa për amvisëri të jetë e saktë. Nëse kontrolli tregon se janë paguar tarifa të gabuara për kujdesin ndaj fëmijëve, atëherë do të bëhet një rregullim. Nëse është paguar tarifë më ulët, atëherë ne do ta dërgojmë një faturë retroaktive. Nëse ke paguar më shumë, atëherë komuna ta kthen dhe ta paguan ndryshimin.



Çështje e saktësisë

Kjo është një çështje e saktësisë që familjet të trajtohen në mënyrë të njëjtë dhe t'i paguajnë tarifat konform normës në fuqi. Është po aq e rëndësishme për ne që të paguajmë prapa dhe që t'i kërkojmë paratë. Kontrollimet e tarifave po bëhen me dy vjet vonesë për shkak se të dhënat e Administratës së Tatimit nuk janë në dispozicion më heret.

Shumica dërmuese e kujdestarëve kanë paguar tarifën e saktë dhe nuk do të ndikohen nga kjo.

Kur do të bëhet kontrollimi?

Ne do t'i dërgojë pagesat prapa dhe faturat për vitin 2014 gjatë verës së vitit 2016. Pastaj kontrollimet do të bëhen për çdo vit.

Informacione & pyetje

Më shumë informacione si dhe pyetje të zakonshme ka në faqen tonë të internetit www.uddevalla.se/avgiftskontroll

Ti gjithashtu mund të marrësh ndihmë edhe nëpërmjet avgiftskontroll@uddevalla.se



www.uddevalla.se/avgiftskontroll